


BROSHURË INFORMATIVE PËR VOTUESIT

ÇFARË ËSHTË PUSHTETI LOKAL DHE SI E ZGJEDHIM ATË

INFORMATA
LEHTË TË
KUPTUESHME





BROSHURË INFORMATIVE PËR VOTUESIT

ÇFARË ËSHTË PUSHTETI LOKAL DHE SI E ZGJEDHIM ATË

INFORMATA LEHTË TË KUPTUESHME

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve dhe
Misioni i OSBE-së në Shkup
në vitin 2021 botuan Doracakun
“Çfarë është pushteti lokal dhe si e zgjedhim atë”.
Doracaku është i dedikuar për votuesit.

Në këtë broshurë Doracaku i përmendur është shkruar
në format lehtë të kuptueshëm.
Broshura është përgatitur në vitin 2021
në kuadër të projektit
“Mbështetje për qeverisjen demokratike dhe proceset për inkluzion”
të Misionit të OSBE-së në Shkup, në bashkëpunim me
Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Botimi origjinal i Doracakut
“Çfarë është pushteti lokal dhe si e zgjedhim atë”
paraqet verzion përfundimtar dhe zyrtar.

Këtë broshurë e përshtatën
në format lehtë të kuptueshëm
vetëpërfaqësuesit e Shoqatës SOLEM
dhe ndihmësit e tyre.

Tekstin e përshtatën vetëpërfaqësuesit:
Iva Shuminovska
Kristijan Ristevski
Stefan Peshiç

Përkthimi nga maqedonishtja në shqip: Fatos Kica

Lekturoi: Luljeta Adili-Çeliku

Ilustrimet: Igor Stevkovski

Disenji grafik dhe shtypi: Poliesterdej

Kjo broshurë është në përputhje me

standardet evropiane për lexim dhe kuptim të lehtë të informatave.

Mësoni më shumë në: www.inclusion-europe.eu/easy-to-read/

Ky botim nuk reflekton

këndvështrimet dhe qëndrimet e

Misionit të OSBE-së në Shkup.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Përmbajtja e këtij botimi

mund lirisht të përdoret dhe shumëzohet

për qëllime edukative dhe qëllime tjera jokomerciale

me kusht që në çdo riprodhim të tillë

të citohen si burime

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe

Misioni i OSBE-së në Shkup.

PËRMBAJTJA

VETËQEVERISJA LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT	5
ORGANET E KOMUNËS	9
ZGJEDHJE LOKALE SI ZGJEDHEN ORGANET E KOMUNËS	13
QEVERISJA DEMOKRATIKE	33
KOMPETENCAT E KOMUNËS	39
FINANCIMI I KOMUNAVE	47
PJESËMARRJA E DREJTPËRDREJTË	50
E QYTETARËVE NË VENDIMMARRJEN	50
E KOMUNAVE.	50
KONTAKTE	53

VETËQEVERISJA LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Me qëllim të realizimit të të drejtave të veta dhe plotësimin e nevojave në vendin ku jetojnë qytetarët organizohen në njësi të vetëqeverisjes lokale.

Njësi të vetëqeverisjes lokale janë:


- komunat
- Qyteti i Shkupit.

Komuna është bashkësi e njerëzve që jetojnë në një rajon të caktuar.

Territori i komunës është i përcaktuar me ligj.

Në kuadër të një komune banorëve u mundësohen shërbime për të cilat kompetente është komuna:

- arsim
- mbrojtja e fëmijëve
- mbrojtja e të moshuarve
- furnizimi me ujë
- mbledhja e mbeturinave
- mirëmbajtja e parqeve
- sport
- të tjera.



Që të mund të funksionojë
dhe t'ua sigurojë shërbimet qytetarëve
komuna ka:

- organe komunale
- administratë komunale
- shërbime të organizuara publike.

Organe komunale janë:

- Kryetari i Komunës
- Këshilli i Komunës.

Administratë komunale janë të punësuarit në komunë.

Shërbime të organizuara publike janë:

- ndërmarrjet publike
- institucionet publike.


Ndërmarrjet publike janë kompani
të cilat i ka themeluar komuna
me qëllim që të gjithë qytetarëve
në atë komunë t'u sigurojë:

- furnizim me ujë
- mbledhje të mbeturinave
- transport udhëtarësh
- parqe
- ndihmë me qentë endacakë.



Institucione publike janë:

- çerdhet
- bibliotekat
- teatrot
- sallat e sportit.



Komunat përbëhen nga një ose më shumë vendbanime në të cilat jetojnë qytetarët dhe që kanë nevoja dhe interesat të përbashkëta.

Interesat e qytetarëve dallojnë.

Çdo vendbanim ka nevoja të ndryshme.

Nevojat e fshatrave dhe të qyteteve janë të ndryshme.

Vetëqeverisja lokale në

Republikën e Maqedonisë së Veriut

është e organizuar në 80 komuna dhe në Qytetin e Shkupit.

Rajoni ku formohet komuna është

një tërësi gjeografike dhe ekonomike.

Vendbanimet e afërta mund të komunikojnë lehtë.

Ndërtesa komunale është qendra e komunës.

Qytetarët vendosin për nevojat dhe interesat e komunës ku jetojnë.

Qyteti i Shkupit është qyteti më i madh në

Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Si qytet më i madh është njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale.

Në qytetin e Shkupit ka 10 komuna.

Ato janë:

- Aerodromi
- Buteli
- Gazi Baba
- Gjorçe Petrovi
- Karposhi
- Kisella Voda
- Saraji
- Qendra
- Çairi
- Shuto Orizarja.

Për disa nevoja të qytetarëve përgjegjës është Qyteti i Shkupit.

Për disa nevoja të qytetarëve përgjegjëse janë komunat ku ata jetojnë.

Ekziston ligj i posaçëm ku shkruan:

- për çka është përgjegjës Qyteti i Shkupit
- për çka janë përgjegjëse komunat.

Qytetarët e Shkupit në zgjedhjet lokale në të njëjtën kohë zgjedhin:

- pushtetin lokal në komunën ku jetojnë
- pushtetin lokal të qytetit të Shkupit.

Të gjithë qytetarët votojnë në komunën ku banojnë.

ORGANET E KOMUNËS

Komunat kryejnë detyrat e tyre përmes organeve të tyre.

Ligji për vetëqeverisje lokale përcakton detyrat e organeve të komunës.

Organe të komunës janë:

- Këshilli
- kryetari i komunës.

Këshilli i komunës përfaqëson qytetarët në komunë.

Anëtarët e Këshillit të komunës zgjidhen në zgjedhje lokale.

Anëtarët e Këshillit të komunës zgjidhen çdo 4 vite.

Numri i anëtarëve në Këshillin e komunës varet nga numri i banorëve në komunë.

Komunat me pak banorë kanë numër më të vogël të anëtarëve në Këshillin e komunës.

Komunat me më shumë banorë kanë numër më të madh të anëtarëve në Këshillin e komunës.

Numri i anëtarëve në Këshillin e komunës është qartë i përcaktuar me Ligjin për vetëqeverisje lokale.



Këshilli sjell vendime për:

- Statutin e komunës
- buxhetin e komunës
- raportin vjetor të komunës
- çmimin e shërbimeve të cilat i arkëton komuna
- themelon ndërmarrje publike
- kontrollon si kanë punuar ndërmarrjet publike
- themelon institucione publike
- kontrollon si kanë punuar institucionet publike
- vendos çfarë shërbimesh do të zhvillohen në komunë
- përcakton mënyrën e pagesës së atyre shërbimeve
- vendos për qiradhënien e pronës në pronësi të komunës
- vendos për shitjen e pronës në pronësi të komunës
- kryen kontroll si shpenzohen paratë e komunës
- të tjera.

Statuti paraqet dokumentin me të cilin përcaktohet:

- si është e organizuar komuna
- çfarë dhe si do të punojë komuna.

Buxheti i komunës është plan për mbledhjen dhe shpenzimin e parave me të cilat disponon komuna.

Ato para komuna i siguron nga:

- qytetarët e komunës
- shitja e pronës së komunës
- qiradhënia e pronës së komunës
- lejet e ndërtimit të objekteve
- shteti.

Në fillim të vitit komuna bën plan
si do t'i shpenzojë paratë me të cilat disponon.
Në fund të vitit komuna raporton
se për çka i ka shpenzuar paratë.

Për shqyrtimin e çështjeve të një fushe të caktuar
Këshilli mund të formojë komisione nga përbërja e tij.
Çdo komision merret me çështje të një fushe.

Mund të formohet komision sporti.

Ai merret me

zhvillimin e aktiviteteve sportive

dhe avancimin e aktiviteteve sportive në komunë.

Mund të formohet

komision për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Ai merr vendime

për mbrojtje më të mirë të të drejtave të fëmijeve.

Mund të formohet komision për veprimtari komunale.

Ai merret me

shërbime që u nevojiten qytetarëve në komunë.

Qytetarët e komunës duhet të kyçen
në punën e Këshillit.

Kryetari i komunës është përgjegjës për:

- përfaqësimin e komunës
- nënshkrimin e dokumenteve në emër të komunës
- kontrollimin nëse vendimet e Këshillit janë në pajtim me ligjin
- publikimin e vendimeve të Këshillit në buletin zyrtar të komunës
- kujdesin lidhur me zbatimin e vendimeve të Këshillit
- propozimin e Këshillit për miratimin e rregulloreve
- propozimin e planit për shpenzimin e parave të komunës
- realizimin e buxhetit gjegjësisht
- zgjedhjen e drejtorëve të shërbimeve publike që ka themeluar komuna
- udhëheqjen me të punësuarit në komunë
- kujdesjen për pronën e komunës
- të tjera.

Të punësuarit në komunë i quajmë administratë komunale.

Të punësuarit në komunë kryejnë detyrat

që janë në kompetencë të komunës.

Të punësuarit në komunë nuk zgjedhen në zgjedhje lokale.

Të punësuarit në komunë punësohen me konkurs publik.

Të punësuarit në komunë nuk duhet të ndërrohen

kur zgjedhet kryetari i ri i komunës.

ZGJEDHJE LOKALE

SI ZGJEDHEN ORGANET E KOMUNËS

Në zgjedhje lokale zgjedhet:

- Këshilli i komunës
- Kryetari i komunës.

Në zgjedhjet lokale votohet në mënyrë të fshehtë.

Kjo do të thotë se askush nuk guxon të kërkojë:

- t'i shpjegosh pse ke votuar ashtu siç ke votuar
- t'i tregosh për kënd ke votuar.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut

zgjedhjet lokale mbahen çdo 4 vite.

Zgjedhjet lokale mbahen në muajin tetor.

Në të njëjtën kohë mbahen zgjedhje në:

- të gjitha 80 komunat
- në qytetin e Shkupit.

Zgjedhjet lokale i shpall

Kryetari i Kuvendit të

Republikës së Maqedonisë së Veriut.

E drejta për t'u zgjedhur dhe e drejta e kandidimit

Kandidat për kryetar apo kryetare komune

mund të jetë secili qytetar që:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut
- ka mbushur 18 vjet
- nuk i është marrë aftësia për veprim
- jeton në komunën ku do të kandidohet.

Kandidati për anëtar të Këshillit të komunës

mund të jetë secili qytetar i cili:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut
- ka mbushur 18 vjet
- nuk i është marrë aftësia për veprim
- jeton në komunën ku do të kandidohet.

Nuk mund të jesh kandidat në zgjedhjet lokale nëse:

- je në burg derisa zgjasin zgjedhjet
- ke qenë në burg më shumë se 6 muaj.

Kandidatët për zgjedhje lokale propozohen nga:

- partitë politike
- qytetarët.

Nëse qytetarët duan të propozojnë listë të kandidatëve në zgjedhje lokale ata paraprakisht duhet të sigurojnë numër të caktuar të nënshkrimeve nga qytetarë dhe qytetare që mbështesin atë kandidat.

Numri i nënshkrimeve që duhet të sigurohen varet nga numri i banorëve në komunë.

Në komunat ku ka numër të konsiderueshëm të banorëve shqiptarë listat e kandidatëve do të jenë në:

- gjuhën maqedone
- gjuhën shqipe.

Në komunat ku ka numër të konsiderueshëm të banorëve romë listat e kandidatëve do të jenë në:

- gjuhën maqedone
- gjuhën rome.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve shtyp fletëvotime për secilën komunë veç e veç.

Votuesit kur votojnë marrin nga 2 fletëvotime:

- fletëvotim në të cilin votojnë për kryetarin e komunës ku jetojnë
- fletëvotim në të cilin votojnë për Këshillin komunal të komunës ku jetojnë.

Votuesit e qytetit të Shkupit kur votojnë

marrin nga 4 fletëvotime:

- fletëvotim në të cilin votojnë për kryetarin e komunës ku jetojnë
- fletëvotim në të cilin votojnë për Këshillin komunal të komunës ku jetojnë
- fletëvotim në të cilin votojnë për kryetarin e komunës së Qytetit të Shkupit
- fletëvotim në të cilin votojnë për Këshillin e Qytetit të Shkupit.

Çfarë përmban fletëvotimi?

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve përcakton:

- formën e fletëvotimit
- përmbajtjen e fletëvotimit.

Fletëvotimet kanë

shenja mbrojtëse për t'u

mbrojtur nga keqpërdorimi.

Ngjyra e fletëvotimeve është e ndryshme për:

- kryetar komune
- anëtar të Këshillit të Komunës.



Në pjesën e epërme të fletëvotimit është shkruar:

- emri i komunës
- numri i vendvotimit.

Pason lista me emra të kandidatëve dhe kush i ka kandiduar.

Në fletëvotimin për zgjedhje të kryetarit të komunës janë shkruar emrat e kandidatëve për kryetar komune.

Në fletëvotimin për zgjedhje të anëtarëve të Këshillit janë shkruar:

- emrat e partive politike që propozojnë përbërjen e Këshillit
- emrat e bartësve të listave të këshilltarëve për secilën parti.

Emrat e gjithë kandidatëve të propozuar për Këshill mund t'i shohësh dhe lexosh:

- në media
- në listën e vendosur para vendvotimit ku voton.

Voton në atë mënyrë që në fletëvotimin për kryetar komune me stilolaps të kaltër rrethon numrin rendor para emrit të kandidatit për të cilin do të votosh.

Voton në atë mënyrë që në fletëvotimin për anëtarët e Këshillit të komunës me stilolaps të kaltër rrethon numrin rendor para emrit të bartësit të listës.

Nuk je i/e detyruar që në të dy fletëvotimet të votosh për partinë e njëjtë politike.

Votimi është i fshehtë.

Çdo votues mund të votojë vetëm një herë.

Personave me shikim të dëmtuar u mundësohet shabllon me alfabetin e Brajit.

Zgjedhja e kryetarit ose kryetares së komunës

Kandidati për kryetar komune që ka fituar më së shumti vota në zgjedhje do të zgjedhet kryetar komune.

Të drejtë vote kanë gjithë qytetarët e komunës që:

- janë në moshë madhore
- jetojnë në territorin e asaj komune
- janë të regjistruar në listën zgjedhore.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut personat të cilave iu është marrë aftësia e veprimit dhe për të cilët gjykata ka caktuar se nuk mund të shprehen në mënyrë të lirshme nuk u lejonet të votojnë.

Votohet për një nga kandidatët e shënuar në fletëvotim.

Zgjedhjet për kryetar komune mund të kenë

- një rreth (cikël) votimi
- dy rrethe votimi.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve përcakton nëse do të ketë rreth të dytë votimi.

Kjo varet nga numri i votuesve që kanë votuar në rrethin e parë.

14 ditë nga përfundimi i rrethit të parë mbahet rrethi i dytë i votimit.

Në rrethin e dytë zgjedhet në mes dy kandidatëve.

Këto kandidatë kanë fituar më së shumti vota në rrethin e parë.

Emrat e kandidatëve tjerë nuk figurojnë më në fletëvotim.

Kryetar komune do të zgjedhet ai kandidat që ka fituar më shumë vota në rrethin e dytë.
Nëse nuk zgjedhet askush
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut zgjedh një person që do ta ushtrojë detyrën e kryetarit të komunës.
Pastaj në atë komunë sërish shpallen zgjedhje të reja.

Zgjedhja e anëtarëve dhe anëtareve të Këshillit të Komunës

Ke të drejtë vote nëse:

- je në moshë madhore
- jeton në atë komunë
- je i/e regjistruar në listën zgjedhore.

Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit komunal bëhet sipas modelit proporcional me lista të mbyllura.



Listë e mbyllur do të thotë se voton për një grup kandidatësh.

Kandidatët i propozon propozuesi i listës.

Nuk voton për secilin person veç e veç.

Voton për një grup politik.

Se sa këshilltarë do të ketë një opcion politik varet nga numri i votave që ai opcion politik ka fituar në zgjedhje.

Kur zgjedhen anëtarët e Këshillit komunal votohet vetëm një herë.

Pas përfundimit të zgjedhjeve në

Republikën e Maqedonisë së Veriut ka:

- 81 kryetarë komunash
- 81 këshilla komunalë.

Në Këshill marrin pjesë edhe gra edhe burra.

Kryetar komune mund të jetë edhe një grua edhe një burrë.

Ata vendosin në vend të qytetarëve.

Koha gjatë së cilës ata vendosin në vend të qytetarëve quhet mandat.

Mandati zgjat 4 vite.

Kryetari i komunës gjatë mandatit të tij/saj

pushon së punuari në vendin

paraprak të punës.

Funksionin e kryetarit të komunës e kryen

me orar të plotë.

Për këtë merr rrogë mujore.

Anëtarët e Këshillit të komunës

vazhdojnë të punojnë në

vendet e tyre të punës.

Funksionin e këshilltarit e ushtrojnë në mënyrë plotësuese.

Për këtë paguhen.

Ligji e përcakton se sa të holla do të marrin.

Personi që është zgjedhur për kryetar komune nuk mund të jetë në të njëjtën kohë edhe:

- kryetar i Republikës së Maqedonisë së Veriut
- deputet në Kuvend
- kryeministër
- ministër
- gjykatës
- tjetër.

Nëse je kryetar komune nuk mund të jesh edhe anëtar i Këshillit të komunës.

Nëse je anëtar i Këshillit të komunës nuk mund të jesh edhe kryetar komune.


Fushata zgjedhore dhe mediat

Fushata zgjedhore është prezentim publik i kandidatëve që marrin pjesë në zgjedhje.

Ata kanë plane për komunën.

Planet i prezentojnë përmes:

- tubimeve publike
- ngjarjeve
- pllakatave
- video prezentimeve
- shpërndarjes së fletushkave
- debateve në radio
- debateve në televizion.



Fushata zgjedhore është e ndaluar:

- 1 ditë para ditës së zgjedhjeve
- ditën e zgjedhjeve.

Ajo quhet heshtje zgjedhore.

Ditën e zgjedhjeve

mediave u lejohe

të raportojnë për procesin zgjedhor.

Media janë:

- gazetat
- televizionet
- radio stacionet
- portalet e internetit.

Të gjitha mediat duhet t'u mundësojnë

të gjithë kandidatëve mundësi të barabarta

për t'i prezentuar planet e tyre.

Televizionet që shikohen në mbarë vendin

duhet të sigurojnë përkthim në

gjuhën e simboleve për personat me dëgjim të dëmtuar.

Secili kandidat duhet ta ketë

mundësinë të prezentohet para qytetarëve

në mënyrë që është e kuptueshme për to.

Kandidatët nuk guxojnë t'i prezentojnë

deri sa emitohen emisione për fëmijë.



Financimi i zgjedhjeve lokale

Zgjedhjet lokale financohen me paratë e komunës.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve siguron:

- kuti votimi
- paravanë
- fleta votimi
- material informativ.

Nëse një komunë nuk ka të holla për zgjedhje lokale paratë për organizimin e zgjedhjeve sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Për fushatën zgjedhore nuk guxon të merren para nga:

- buxheti i komunës
- ndërmarrje publike
- institucione publike
- shoqata qytetarësh
- bashkësi fetare
- qeveri të huaja
- organizata ndërkombëtare.

Fushatën e vetë zgjedhore partia politike

mund ta financojë nga:

- mjetet financiare me të cilat disponon partia politike
- donacionet që pranon partia
- nga kredi të dedikuara për zgjedhje.

Pas zgjedhjeve të gjithë që kanë marrë pjesë në zgjedhje duhet të dorëzojnë raport.

Në raport shkruajnë se si i kanë shpenzuar paratë.

Raport dorëzojnë:

- partitë politike
- mediat
- Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.

Në fund organet zgjedhore shpallin rezultatet e zgjedhjeve.

Pas shpalljes së rezultateve me punë fillojnë:

- kryetari i komunës
- dhe anëtarët e Këshillit.

Procedura e votimit

Votimi mbahet ditën e përcaktuar.

Vendimin për shpalljen e Zgjedhjeve Lokale e merr Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Votimi fillon në ora 07:00 dhe përfundon në ora 19:00.


Mund të votosh nëse:

- je i/e regjistruar në listën zgjedhore
- posedon dokument të vlefshëm për identifikim personal.



Dokumente për identifikim personal janë:

- letërnjoftimi
- pasaporta.



Procedura për votim fillon në atë mënyrë që:

- Votuesit presin radhën të votojnë një nga një.
- Këshilli Zgjedhor do ta verifikojë identitetin tënd.

Identiteti personal verifikohet me:

- dokument të vlefshëm për identifikim personal
- gjurmë gishtash.

Nuk do të mund të votosh nëse:

- nuk ke dokument të vlefshëm për identifikim personal
- gjurmët e gishtave nuk përputhen me gjurmët e gishtave në listën elektronike zgjedhore.

Gjurma e gishtit në listën elektronike zgjedhore është e njëjtë me gjurmën e gishtit që merret kur nxjerr:

- letërnjoftim
- pasaportë.

Këshilli Zgjedhor kontrollon nëse paraprakisht ke votuar.

Kjo bëhet kështu.

Me gishtin tregues të dorës së djathtë shtyp për të lënë gjurmë.

Nëse nuk ke tregues të djathtë shtyp me gishtin tregues të dorës së majtë.

Nëse nuk ke të dy gishtat tregues shtyp me gishtin e radhës.

Në ekranin e monitorit do të paraqitet:

- fotografia jote
- numri yt rendor në listën zgjedhore.

Duhet të nënshkruhesh në listën zgjedhore.

Pas kësaj procedure një anëtar i Këshillit Zgjedhor do të të japë 2 fletëvotime.



Fletëvotimi i parë është për të zgjedhur kryetarin e komunës ku jeton.

Fletëvotimi i dytë është për të zgjedhur anëtarët e Këshillit në komunën ku jeton.

Votuesit e qytetit të Shkupit marrin 4 fletëvotime.

Një fletë për zgjedhjen e kryetarit në komunën ku jeton.

Një fletë për zgjedhjen e anëtarëve në Këshillin e komunës ku jeton.

Një fletë për zgjedhjen e kryetarit të komunës së Qytetit të Shkupit.

Një fletë për zgjedhjen e këshilltarëve në Këshillin e Komunës së Qytetit të Shkupit.

Fletëvotimet vulosen

me vulën e vendvotimit në pjesën e paraparë për vulosje.

Voton vetëm pas paravanit votues.

Voton duke rrethuar numrin rendor para vetëm një kandidati

me stilolapsin që është vendosur pas paravanit.

Ky stilolaps është me ngjyrë të kaltër.



Fletëvotimi do të jetë i pavlefshëm nëse:

- rrethon më shumë kandidatë
- shkruan diçka në fletëvotim
- rrethon me flomaster
- rrethon me laps
- rrethon me stilolaps të kuq
- rrethon me stilolaps të zi.

Pasi që të kesh rrethuar numrin para kandidatit fleta paloset.

Çdo fletëvotim futet në kuti të veçantë votimi.

E merr dokumentin për identifikim personal.

Largohesh nga vendvotimi.



Nëse ka problem me pajisjet

Këshilli Zgjedhor ka procedurë të posaçme të cilën duhet ta ndjekë.

Do ta kontrollojë identitetin tënd personal.

Këtë e bën duke kontrolluar një dokumet për identifikim personal.

Do të kontrollojë nëse paraprakisht ke votuar.

Do ta shënojë numrin tënd amë.

NAQ është shkurtesë për numrin amë të qytetarit.

Çdo qytetar i

Republikës së Maqedonisë së Veriut ka NAQ të ndryshëm.

Do të marrë gjurmë gishti.

Kjo procedurë votimi

përdoret për votuesit që:

- votojnë nga shtëpia
- janë të vendosur në një institucion
- janë në burg
- janë në arrest shtëpiak
- jetojnë në shtete tjera.

Nga shtëpia votojnë personat që nuk mund të shkojnë në vendet e votimit.


Nëse nuk mund të shkosh të votosh në vendvotim duhet të lajmërohesh në KSHZ.

KSHZ-ja është Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.
Në këtë rast, përfaqësues të Këshillit Zgjedhor
do të vijnë të ti në shtëpi
që të mund të votosh
para ditës së zgjedhjeve.

PROCESI I VOTIMIT ZHVILLOHET
EKSKLUZIVISHT SIPAS RENDIT
NË VIJIM:

1. VERIFIKIMI I DOKUMENTEVE
PËR IDENTIFIKIM PERSONAL
2. KONTROLLI ME PAJISJE PËR
IDENTIFIKIM BIOMETRIK
3. KONTROLLIMI DHE
NËNSHKRIMI NË LISTËN E
VOTUESVE
4. DHËNIA E FLETËS SË
VOTIMIT
5. VOTIMI PAS PARAVANËVE TË
VOTIMIT
6. VENDOSJA E FLETËVE
TË VOTIMIT NË KUTITË E
VOTIMIT





Votimi i personave të cilëve u duhet ndihmë gjatë votimit

Personat me aftësi të kufizuar kanë të drejtë të votojnë në zgjedhje.

Nuk kanë të drejtë të votojnë vetëm

personat të cilave iu është marrë aftësia e veprimit

dhe për të cilët gjykata ka caktuar

se nuk mund të shprehen në mënyrë të lirshme

Personat me aftësi të kufizuar kanë të drejtë ndihme gjatë votimit.

Ndihmë mund të të japë një person të cilit i beson.

Vetë zgjedh se kush do të të ndihmojë.

Nëse votuesi nuk mund të vijë në vendin e votimit

Këshilli Zgjedhor duhet të gjejë mënyrë

që votuesi të hyjë në vendvotim për të votuar.

Nëse nuk ke dikë të të ndihmojë për të votuar

e ty të duhet ndihmë

Këshilli Zgjedhor do t'i drejtohet për ndihmë

një votuesi që është prezent në vendvotim.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve bashkëpunon me shoqatat qytetare.

Së bashku ato përgatisin materiale.

Materialet u ndihmojnë personave me aftësi të kufizuara

që më lehtë të përfshihen në procesin zgjedhor.

Përgatisin:

- mbështetëse anësore që ata të mund të nënshkruhen në listën zgjedhore
- shabllone me alfabetin e Brajtit
- posterë me ilustrime se si votohet të cilat vendosen para secilit anëtar të Këshillit Zgjedhor
- materiale tjera.



Parashtresat e votuesve

Nëse për arsye të ndryshme nuk mund të votosh duhet ta lajmërosh këtë në Komisionin zgjedhor komunal.

Anëtarët e Këshillit Zgjedhor do të japin një formular.

Ata do të të ndihmojnë edhe ta plotësosh formularin.

Një kopje të formularit do t'ia japësh atyre.

Kopja tjetër e formularit është për ty.

Në afat prej 2 orësh Komisioni Zgjedhor Komunal do të marrë vendim për parashtresën tënde.

Parashtresën mund ta plotësosh edhe përmes internetit në ueb-faqen [www.prigovori.sec.mk](https://prigovori.sec.mk).



Nëse nuk pajtohesh më vendimin e tyre

ke të drejtë të ngresh padi në Gjykatën Administrative.

Mund të kërkoш ndihmë edhe nga ndonjë organizatë tjetër.

Në fund të kësaj broshure ka listë të organizatave të cilat do të të ndihmojnë.

Nëse mendon se është shkelur e drejta jote e votës

këtë mund ta raportosh edhe tek:

- Zyra e Avokatit të Popullit
- vëzhguesit e zgjedhjeve
- organizatat joqeveritare
- policia.

Mos hesht nëse mendon se është shkelur e drejta jote e votës.

Kundërvihu secilit që përpiqet ta rrezikojë të drejtën tënde të votës.

QEVERISJA DEMOKRATIKE

Çfarë është qeverisje demokratike?

Si duhet të punojnë komunat?

Cilat rregulla duhet t'i respektojnë organet komunale gjatë punës së tyre?

Në demokraci qytetarët ua japin të drejtën personave që kanë zgjedhur në zgjedhje që të marrin vendime në emrin e tyre.

Në demokraci pranohen

ato vendime për të cilat kanë votuar shumica e qytetarëve.

Vendimet e marra në këtë mënyrë duhet t'i respektojnë të gjithë.

Në demokraci duhet të respektohen edhe nevojat e qytetarëve që janë në numër më të vogël.

Për shembull:

Edhe pse shumica e qytetarëve mund të shohin megjithatë fletat e votimit shtypen edhe në alfabetin e Brajlit.

Në këtë mënyrë edhe personat me shikim të dëmtuar do të mund të votojnë në mënyrë të pavarur.

Në shoqëritë demokratike

numri më i madh i vendimeve merren në komuna.

Komunat e dinë më mirë sesa Qeveria cilat janë nevojat e qytetarëve të tyre.

Për shembull:

Komuna e di më mirë sesa Qeveria sa fëmijë në komunë duhet të shkojnë në çerdhe.



Komuna bën plane

a duhet të hapet çerdhe e re

nëse nuk ka vende të mjaftueshme për fëmijët.

Komuna mund të ndërtojë çerdhe të re me:

- para nga buxheti i komunës
- para nga Qeveria.

Në qeveritë demokratike

qytetarët kanë të drejtë dhe përgjegjësi

të marrin pjesë në jetën politike.

Republika e Maqedonisë së Veriut është:

- e pavarur
- qytetare
- shtet demokratik.

Në të garantohen:

- të drejtat e njeriut
- liritë qytetare.

Përfaqësuesit në pushtet janë njerëz

të cilët qytetarët i zgjedhin në zgjedhje.

Përfaqësuesit në pushtet marrin vendime

sipas ligjeve të shtetit.

Nëse dikush keqpërdor

besimin që ia kanë dhënë qytetarët

qytetarët mund ta ndërrojnë atë.

Vendi ynë vazhdimisht aspiron për:

- zhvillimin e demokracisë
- respektimin e parimeve demokratike të qeverisjes.

Cilat janë parimet themelore të qeverisjes demokratike?

Të drejtat e njeriut

Në shoqëritë demokratike

shteti dhe institucionet aspirojnë t'i mbrojnë:

- të drejtat e qytetarëve
- liritë e qytetarëve.

Disa nga të drejtat më të rëndësishme të njeriut janë:

- e drejta për jetë
- ndalesa për të torturuar
- e drejta për liri
- e drejta për siguri
- e drejta për gjykim të drejtë
- e drejta për jetë private
- e drejta për jetë familjare
- e drejta për mbrojtje shëndetësore
- ndalesa për diskriminim
- të tjera.

Barazia

Barazia e të gjithë qytetarëve domethënë të gjithë të kenë mundësi të barabarta të realizojnë të drejtat e tyre pavarësisht nga:

- ngjyra e lëkurës
- seksi
- gjinia
- përkatësia etnike
- religjioni
- aftësia
- dhe të ngjashme.



Zgjedhjet korrekte dhe të lira

Zgjedhjet e lira dhe korrekte u japin qytetarëve mundësinë që vetë t'i zgjedhin udhëheqësit e tyre.

Sundimi i ligjit

Për të gjithë qytetarët të gjitha ligjet duhet të vlejnjë njësoj. Të gjithë duhet t'i respektojnë ligjet dhe të ndëshkohen nëse veprojnë kundër ligjit.

Sistemi shumëpartiak

Ekzistojnë më shumë parti që të zgjerohet mundësia e zgjedhjes në votim. Qytetarët dhe qytetaret mund të zgjedhin për liderë të tyre kandidatët më të mirë.

Toleranca politike

Partitë në pushtet duhet t'i realizojnë planet e tyre për të cilën edhe kanë fituar mandatin nga qytetarët në zgjedhje. Mirëpo ata duhet t'i respektojnë edhe nevojat e partive që nuk kanë fituar në zgjedhje.

Neutraliteti i institucioneve shtetërore

Insitucionet shtetërore dhe funksionarët publikë duhet të punojnë:

- profesionalisht
- në mënyrë të paanshme
- të mos përfaqësojnë interesat e një partie të caktuar politike.

Puna e këtillë do të kontribuojë për:

- përmbushjen e nevojave të të gjithë qytetarëve
- jetë më të mirë të qytetarëve.

Pjesëmarrja e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes.

Qytetarët zgjedhin përfaqësuesit e tyre në zgjedhje.

I zgjedhin në bazë të programit për punë

të cilin kandidatët e ndryshëm e prezantojnë para zgjedhjeve.

Mirëpo përfaqësuesit e zgjedhur e kanë për obligim

që gjatë mandatit të tyre

t'u mundësojnë qytetarëve

të marrin pjesë në vendimmarrje në komunë.

Këtë mund ta bëjnë:

- duke dëgjuar propozimet e qytetarëve
- përmes tubimeve qytetare
- përmes referendumit në komunë.

Në referendum qytetarët shprehin mendimin e tyre

për një çështje të caktuar.

Para se të merret një vendim

duhet të kërkohet mendim nga:

- të gjitha palët e prekura
- personat kompetentë.

Transparenca

Funksionarët publikë lejojnë t'i bëhet kontroll publik punës që bëjnë deri sa janë në funksion publik.

Ata mundësojnë që qytetarët të:

- marrin pjesë në mbledhjet e hapura për publikun
- të marrin informacione.

Llogaridhënia

Përfaqësuesit e zgjedhur fitojnë pushtetin nga qytetarët në zgjedhje.

Për këtë arsye duhet t'i informojnë rregullisht për:

- vendimet e tyre
- rezultatet e punës së tyre.

Kontrolli mbi keqpërdorimin e pushtetit

Secila qeveri mund ta keqpërdorë pushtetin e vet.

Për këtë shkak duhet të kontrollohet puna e saj.

Nëse keqpërdorin pushtetin që ua kanë dhënë qytetarët përfaqësuesit e zgjedhur duhet të dënohen.

Liria ekonomike

Liria ekonomike është aftësia e njerëzve që lirshëm të ndërmarrin aktivitete ekonomike.

Qytetarët ekonomikisht më të varfër mund shumë më lehtë të jenë cak i keqpërdorimeve të ndryshme për qëllime politike.

KOMPETENCAT E KOMUNËS

Cilat janë kompetencat e komunës?

Shërbime për qytetarët sigurohen:

- nga komunat
- nga Qeveria.

Komunat kryejnë punët që janë në interes të qytetarëve që jetojnë në atë komunë.

Komunat në kontinuitet kryejnë këto punë në mënyrë të pavarur:

Planifikimi urban

Komuna vendos si do të duket hapësira e komunës.

Kjo do të thotë se komuna është përgjegjëse për:

- dhënien e lejeve për ndërtim objektësh
- planifikimin e hapësirës
- planifikimin e tokës ndërtimore.

Planifikimi i hapësirës është plan i komunës për atë se ku duhet të ketë:

- ndërtesa
- shtëpi
- parqe
- parkingje
- e të tjera.

Planifikimi i tokës ndërtimore është plan për atë se ku duhet të ketë:

- shtëpi
- ndërtesa.

Planifikimi i tokës ndërtimore është pjesë e planit për rregullimin e hapësirës.

Nëse dëshiron të ndërtosh shtëpi
së pari duhet të ta lejojë komuna.

Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe natyrës

Secila komunë duhet të kujdeset për pastërtinë e komunës.

Komuna duhet të ndërmarrë masa për:

- mbrojtjen nga ndotja e ujit në komunë
- mbrojtjen nga ndotja e ajrit në komunë
- mbrojtjen nga ndotja e tokës në komunë
- mbrojtjen e natyrës
- mbrojtjen nga zhurma
- mbrojtjen nga rrezatimi i dëmshëm.


Zhvillimi ekonomik lokal

Secila komunë duhet të planifikojë si të mbështesë
hapjen e sa më shumë kompanive.

Komuna bashkarisht me kompanitë duhet të gjejë mënyrë
si t'u ndihmojë kompanive të performojnë sa më suksesshëm.

Nëse ka numër më të madh të kompanive në komunë
kjo do të thotë se qytetarët që jetojnë aty do të mund:

- të sigurojnë më shumë shërbime nga kompanitë
- të punësohen në ato kompani.



Shërbimet komunale

Komunat kanë për detyrë të sigurojnë:

- furnizimin me ujë të pijshëm
- kanalizimin e ujërave të zeza
- filtrimin e ujërave të zeza
- ndriçimin publik
- mirëmbajtjen e pastërtisë publike
- mbledhjen e mbeturinave
- organizimin e transportit publik të qytetarëve
- ndërtimin e rrugëve lokale
- mirëmbajtjen e rrugëve
- hapësirat për parkim
- mënjanimin e automjeteve të parkuara me gabim
- ndërtimin e tregjeve
- pastrimin e oxhaqeve
- mirëmbajtjen e parqeve
- mirëmbajtjen e gjelbërimit
- mirëmbajtjen e pyjeve
- mirëmbajtjen e hapësirave rekreative
- mirëmbajtjen e brigjeve lumore në pjesët e urbanizuara
- emërtimin e rrugëve
- emërtimin e shesheve
- emërtimin e urave
- të tjera.



Kultura

Komuna ka për detyrë të sigurojë:

- mbështetje të institucioneve kulturore
- kultivimin e folklorit
- kultivimin e traditave lokale
- kultivimin e zejeve të vjetra
- organizimin e manifestimeve kulturore
- të tjera.


Institucione kulturore në komunë janë:

- bibliotekat
- teatrot
- shtëpitë e kulturës.

Sporti dhe rekreimi

Komuna është e detyruar të sigurojë kushte për:

- zhvillimin e sportit në komunë
- zhvillimin e aktiviteteve rekreative
- organizimin e garave sportive
- organizimin e manifestimeve
- ndërtimin e objekteve të sportit
- mirëmbajtjen e objekteve të sportit
- mbështetjen e federatave të sportit.



Mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve

Komuna menaxhon me:

- çerdhet
- azilet e pleqve në komunë
- kujdesin social për personat me aftësi të kufizuara
- sigurimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar në komunë
- kujdesin social të fëmijëve pa prindër dhe kujdes prindëror
- kujdesin social të fëmijëve me probleme edukative-sociale
- kujdesin social të fëmijëve me aftësi të kufizuar
- kujdesin social të fëmijëve nga familje me një prind
- kujdesin social të fëmijëve në rrugë
- kujdesin social të personave që abuzojnë me drogë
- kujdesin social të personave të prekur nga abuzimi me alkool
- strehimin e personave me rrezik social.

Arsimi

Komuna në bashkëpunim me Qeverinë është përgjegjëse për:

- themelimin e shkollave fillore
- financimin e shkollave fillore
- menaxhimin e shkollave fillore
- themelimin e shkollave të mesme
- financimin e shkollave të mesme
- menaxhimin e shkollave të mesme.

Komunat kanë për detyrë të organizojnë transportin e fëmijëve deri në shkollë.

Komunat janë të detyruara të sigurojnë ushqim për nxënësit e shkollave.

Komunat kanë për detyrë të sigurojnë konvikte nxënësish ku do të mund të vendosen nxënësit që vijnë nga qytete tjera.

Mbrojtja shëndetësore

Komuna ka për detyrë të:

- menaxhojë me rrjetin e organizatave amë të shëndetit publik
- menaxhojë me objektet e mbrojtjes shëndetësore primare
- organizojë edukim shëndetësor
- avancojë shëndetin
- ndërmarrë aktivitete parandaluese
- mbikëqyrë sëmundjet ngjitëse në komunë
- ndihmojë pacientët me nevoja të veçanta
- ndihmojë fëmijët dhe të rriturit që janë viktime të dhunës
- të tjera.

Organizimi i mbrojtjes dhe shpëtimit të qytetarëve

Komuna e ka për detyrë të organizojë

mbrojtjen e qytetarëve në rast të:

- vërshimeve
- tërmetit
- breshërit
- fortunave të fuqishme
- zjarrit
- luftës.

Mbrojtja nga zjarri

Komuna ka për detyrë të organizojë shërbim zjarrfikës që do të intervenojë nëse në komunë ka zjarr.

Mënyrat e ushtrimit të kompetencave

Për të ushtruar kompetencat e tyre komunat mund të themelojnë shërbime publike.

Shërbime publike janë:

- ndërmarrjet publike
- institucionet publike.

Ndërmarrjet publike themelohen për:

- ujësjellës
- kanalizim
- transport udhëtarësh
- mirëmbajtjen e gjelbërimit
- mirëmbajtjen e pastërtisë
- trajtimin e qenëve endacakë.

Institucione publike janë:

- shtëpitë e kulturës
- bibliotekat
- qendrat për kujdes social
- konviktet e nxënësve të shkollave të mesme

Komunat e vogla mund të formojnë shërbime publike të përbashkëta.

Për ushtrimin e kompetencave të caktuara komuna mund të bashkëpunojë edhe me:

- shoqata qytetare
- kompani private.

Komunat poashtu mund të sigurojnë

mbështetje për aktivitete të shoqatave

që kanë rol specifik në komunë si:

- kujdesin e personave me aftësi të kufizuara
- arsimin joformal
- klubet e sportit
- tjera.

Mbikëqyrja e punës së komunave

Puna e komunës

mbikëqyret rregullisht.

Mbikëqyrja bëhet për të parë nëse:

- komuna ka respektuar ligjet e shtetit kur ka marrë vendime
- si i ka shpenzuar komuna paratë.

Të gjithë qytetarët e komunës kanë të drejtë të:

- parashtrojnë pyetje në komunë
- japin propozim në komunë.

Kryetari i komunës ka për detyrë t'i përgjigjet qytetarit në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimin të:

- pyetjes
- propozimit.

FINANCIMI I KOMUNAVE

Komunave u duhen mjaftueshëm financa që të munden të:

- ushtrojnë detyrat e tyre
- sigurojnë shërbimet për qytetarët.

Financat janë paratë me të cilat disponon komuna.

Mënyra e financimit të komunave është e paraparë me ligj.

Mjetet financiare komunat i sigurojnë nga:

- të ardhurat vetanake
- transferet dhe dotacionet
- huazimet.

Të ardhura vetanake janë paratë të cilat komuna i mbledh vetë nga:

- qytetarët që jetojnë në komunë
- kompanitë që veprojnë në komunë.

Paratë komuna i mbledh nga:

- tatimet
- lejet për ndërtim
- dënimet
- qiradhënia e hapësirave të komunës.

Këshilli Komunal përcakton lartësinë e:

- tatimit
- qirasë
- të dhënave tjera.

Transfere dhe dotacione janë paratë që komuna i siguron nga Qeveria.

Komuna pranon para nga Qeveria për:

- çerdhet
- shkollat
- azilet e pleqve
- projektet e aprovuara
- kulturë
- ndërtimin e rrugëve
- të tjera.

Huazimi

Komuna mund të marrë kredi nga:

- banka
- Qeveria.

Çdo huazim duhet të aprovohet nga Këshilli Komunal.

Nëse komuna duhet të huazojë

për afat më shumë se një vit

Këshilli duhet t'i pyesë qytetarët ç'mendim kanë për këtë.

Buxheti është dokumenti më i rëndësishëm

që miraton Këshilli Komunal.

Buxheti është plan vjetor

për mbledhjen dhe shpenzimin e parave të komunës.

Në ueb-faqen e komunës duhet të publikohen:

- buxheti
- raporti vjetor për atë se çfarë është realizuar sipas buxhetit.

Me buxhet përcaktohet

se çka planifikon të bëjë komuna

gjatë vitit.

Komuna duhet t'i përfshijë qytetarët
kur vendos se për çka do të shpenzohen paratë e komunës.
Komunat kanë mjete të kufizuara financiare.
Për këtë arsye është me rëndësi të vendoset
si do të shpenzohen paratë e komunës.
Që komunat të kenë mjaftueshëm para për të funksionuar
qytetarët duhet t'i paguajnë tatimet në kohë.

PJESËMARRJA E DREJTPËRDREJTË E QYTETARËVE NË VENDIMMARRJEN E KOMUNAVE

Qytetarët mund të marrin pjesë në vendimmarrjen për çështje të rëndësishme në komunë.

Atë mund ta bëjnë përmes:

- iniciativave qytetare
- tubimeve qytetare
- referendumit
- parashtresave
- propozimeve
- tribunave publike
- anketave.

Shpenzimet për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje i mbulon komuna.

Iniciativë qytetare

është e drejta e qytetarëve

t'i propozojnë Këshillit

të zgjidhë një çështje të caktuar në kuadër të kompetencave që ka.

Këshilli është i obliguar të shqyrtojë

nëse iniciativën e mbështesin së paku 10 përqind

e zgjedhësve në komunë.

Këshilli ka për detyrë të zhvillojë diskutimin

më së voni në afat prej 90 ditësh

pas iniciativës së dorëzuar.

Këshilli duhet t'i informojë qytetarët

për vendimin e tij.

Tubim qytetarësh thirret
për zgjidhjen e një problemi në komunë.

Tubim qytetarësh mund të thërras:

- kryetari i komunës
- këshilli i komunës
- qytetarët e komunës.

Nëse së paku 10 përqind e zgjedhësve të komunës kërkojnë
një gjë të tillë komuna duhet të thërras tubim qytetarësh.

Të punësuarit në komunë kanë për detyrë
të organizojnë tubimin e qytetarëve.

Konkluzat e miratuara në tubimin e qytetarëve
shqyrtohen më së shumti 90 ditë.

Pas 90 ditësh komuna duhet t'i informojë qytetarët
për vendimin e saj.

Referendumi

Në referendum qytetarët shprehin mendimin e tyre
për një çështje të caktuar.

Këshilli duhet të shpallë referendum
nëse së paku 20 përqind e zgjedhësve në komunë
kërkojnë të ketë referendum.

Këshilli mund të shpallë referendum
me vetëiniciativë.

Vendimi i miratuar në referendum
është i detyrueshëm për Këshillin.

Ankesat dhe propozimet

Çdo qytetar ka të drejtë të parashtojë propozime në komunë:

- vetë
- së bashku me më shumë qytetarë të komunës.

Kryetari i komunës duhet të krijojë kushte

që qytetarët të mund të parashtrojnë propozime.

Kryetari i komunës është i detyruar t'i përgjigjet propozimit

më së voni 60 ditë nga dita kur është dorëzuar.

Çdo qytetar ka të drejtë të parashtojë ankesa në komunë:

- vetë
- së bashku me më shumë qytetarë të komunës.

Kryetari i komunës duhet të krijojë kushte

që qytetarët të mund të parashtrojnë ankesa.

Kryetari i komunës është i detyruar t'i përgjigjet ankesës

më së voni 60 ditë nga dita kur është dorëzuar.

Tribunat publike, anketat dhe propozimet

Gjatë hartimit të rregulloreve

komuna mund të kërkojë propozime të qytetarëve përmes:

- tribunave publike
- anketave.

KONTAKTE

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve – KSHZ

Telefoni: 02 3244 744

Adresa: rruga “Shën Kirili dhe Metodi” numër 54
1000 Shkup

Posta elektronike: izbori@sec.mk



Republika e Maqedonisë së Veriut
KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Shoqatat që sigurojnë mbështetje për personat me aftësi të kufizuara:

Shoqata qytetare për mbështetje

të personave me nevoja të veçanta **SOLEM** – Shkup

☎ 02/2467-551

✉ info@solem.org.mk



Shoqata për promovimin dhe zhvillimin e shoqërisë inkluzive **INKLUZIVA**

☎ 076 279 662

☎ 076 279 663

✉ inkluziva@gmail.com

🌐 www.inkluziva.mk



POLIO PLUS – Lëvizje kundër hendikepit

☎ 02 2400 544

✉ polioplus@polioplus.org.mk

🌐 www.polioplus.org.mk



Shoqata qytetare **QENDRA E RESURSEVE**
për prindër të fëmijëve me nevoja të veçanta

☎ 078 290 246

☎ 078 449 851

✉ resursen.centar@yahoo.com

🌐 www.resursencentar.mk



Shoqata qytetare **CIVIL** – Qendra për liri

☎ 02 5209 176

✉ civil@civil.org.mk

🌐 www.civil.org.mk

